

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“VESA 22” sh.p.k

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. Elird Rama, i datelindjes 30/09/1978, i biri i Luanit-it, i lindur ne Peshkopi dhe banues ne Rrugen Don Bosko, Tiranë, identifikuar me leternjoftim nr.038468784 dhe nr personal H809300550 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “VESA 22” sh.p.k

Sot me date **29.03.2023**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “VESA 22” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Ofrimi i sherbimit turizem kulturore, mjeksore, estetike, stomatologjike, historike ne Republiken e Shqiperise si dhe jashte saj. Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fushen e marketingut, reklamimit te produkteve te ndryshme mjeksore, ushqimore industrial dhe jo industrial ne Republiken e Shqiperise si dhe jashte saj. Veprimtari media elektronike on-line ne internet (world wide web), ne platforma dhe/ose rrjete sociale on-line. Veprimtari gazetarie te shkruar, vizive dhe on-line ne internet (world wide web), ne platforma dhe/ose rrjete sociale on-line.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertojne “VESA 22” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rrugen e Barrikadave, Hyrja 1, Ap.54, Tiranë

Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakut mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortakut do ta pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.

3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjetër ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100 (njqind) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Elird Rama**, zotëruese e 1(nje) kuote me vlere 100 lek, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Elird Rama** i cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegeje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.


Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Elird Rama

Elird Rama

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Elird Rama', written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.